



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA)

SHPALL KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN KALENDARIK 2016/2017

Të gjitha detajet rreth grupmoshave dhe numrit të planifikuar të fëmijëve që do të regjistrohen mund t'i gjeni në Institucionin Parashkollor përkatës.

Konkursi do të jetë i hapur prej datës **14 qershor 2016 deri më 28 qershor 2016**. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në Institucionin Parashkollor përkatës çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 15:00.

Shpallja e rezultateve bëhet më 11 korrik 2015 në Institucionin Parashkollor përkatës.

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionet Parashkollore bëhet bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga Drejtoria Komunal e Arsimit (DKA) sipas vendimit 03 nr. 170, dt. 15.06.2015.

Këshillë juridike: Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në Institucionin Parashkollor përkatës dhe nëse sërish janë të pakënaqur me vendimin e institucionit, atëherë mund të ushtrojnë ankesë në DKA. **DKA nuk e shqyrton asnjë ankesë nëse pala paraprakisht nuk ka përgjigje me shkrim në ankesën e ushtruar në Institucionin Parashkollor përkatës.**

Prishtinë, më 14 qershor 2016